

## V E N D I M

### Per ankimin e vendimit te prokurorit

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me trup gjykues të përbërë prej

**GJYQTAR    FATIME DEÇOLLI**

me sekretare gjyqësore **Blerina ORUÇI**, sot në datë **07.08.2017**, ne prani te Prokurorise se Rrethit Gjyqësor Tirane, **prokurore Daniela Sulaj**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kerkesen penale me palë ndërgjyqësore :

**ANKUES:**            **Shoqeria Sherbimi Permbarimor S... shpk**, Tirane, rr. ...  
nr.1, qendra e biznesit S.... Perfaqesuar ne gjykim me autorizim  
dt.04.08.2017 nga zj. Alda Abazi.

**Kunder:**            Vendimit "Per sekuestrimin e dokumentave" date 27.07.2017 Nr. 5613 Prot te prokurorit Ervin Karanxha prane Prokurorise se Rrethit Gjyqësor Tirane, lidhur me procedimin penal Nr. 5613 te vitit 2017 per vepren penale te parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, per te cilin eshte mbajtur Procesverbal "Mbi sekuestrimin e dosjes permbarimore Nr. 0218-15 Regj" nga Of. Pol.Gjyqësore Besjana Reca.

**BAZA LIGJORE:** Neni 212 e vijues i K.Pr.Penale

Gjykata pasi administroi dhe shqyrtoi provat shkresore te depozituara nga palet ndërgjyqësore se bashku me kerkesen ;

Degjoi palen kerkuese qe perfundimisht kerkoi: Pranimin e kerkeses ;

Degjoi prokuroren qe perfundimisht kerkoi: Rrezimin e kerkeses si te pa bazuar ne ligj dhe ne prova ;

## V E R E N :

Se, ankuesi Shoqeria "Sherbimi Permbarimor S..." shpk ka paraqitur para Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane ankimin penal me objekt te siper cituar, referuar te drejtes se parashikuar ne nenin 212 te K.Pr.Penale.

Shoqeria "Sherbimi Permbarimor S..." sh.p.k shtrin funksionin e saj per ekzekutimin e urdherimeve te gjykates sipas vendimeve gjyqësore per leshimin e urdhrit te ekzekutimit

ndaj titujve ekzekutiv te parashikuara ne nenin 510 te K.Pr.Civile dhe vihete ne levizje ne baze te kerkeses se pales kreditore. Konkretisht, ne baze te kerkeses se pales kreditore Micro Credit Albanian sh.a eshte regjistruar dhe vene ne ekzekutim vendimi gjyqesore per leshimin e urdhrimit te ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, si me poshte vijon:

Leshimi i Urdhrit Nr. ... Akti te dates 20.11.2012 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane (Dosja permbarimore me Nr 0186-15 Regj ) per titullin ekzekutiv Kontrate Kredie Nr. ... te dates 09.12.2011.

Bazuar ne Nenet 517, 518, 519, 525 K.Pr.Civile dhe ne zbatim te kerkeses se pales kreditore Sherbimi Permbarimor S... sh.p.k, ka filluar ekzekutimin ndaj pales kredimarrrese B... 2007, debitor solidar E. Q., F. Sh.dhe G. Q., te cilet nuk kishin permblusur detyrimet kontraktuale sipas kontratave te kredise te lidhura me palen kreditore P... Bank sh.a. Midis P... Bank sh.a dhe M... C... A...sh.a ne daten 11.08.2015 eshte lidhur kontrata e cedimit te kredise per titullin Kontrate Kredie Nr. ... te dates 09.12.2011. Sipas kesaj kontrate te cedimit te kredise te drejtat e ish-pales kreditore P... Bank sh.a i morri persiper M... C... A...sh.a si pale e re kreditore.

Pala kreditore M... C... A...sh.a ne daten 30.12.2015 ka paraqitur prane Sherbimit Permbarimor S... sh.p.k kerkese per venien ne ekzekutim te titullit kontraten e kredise Nr. ... te dates 09.12.2011 me pale kredimarrrese B... 2007, debitor solidar E. Q., F. Sh.dhe G. Q.. Kjo dosje permbarimore ka qene per nje periudhe prej 2 vjetesh ne proces ekzekutimi prane shoqerise permbarimore Zyra e Permbarimit A...A... dhe eshte transferuar prane Sherbimit Permbarimor S... me kerkese te pales kreditore M... C... A...sh.a.

Gjate procedures permbarimore permbaruesi gjyqesor Zyra e Permbarimit A...A... dhe Sherbimi Permbarimor S... sh.p.k ka disponuar me vendime, urdhra dhe njoftime te cilat jane komunikuar paleve rregullisht duke i dhene mundesine pales debitore te perdore te gjitha mjetet e duhura ligjore ne zbatim te nenit 609 dhe 610 te K.Pr.Civile per te mbrojtur interesat e saj te ligjshme, te drejte te cilen palet debitore B... 2007, debitor solidar E. Q., F. Sh.dhe G. Q.. Gjate ekzekutimit per nje periudhe prej 5 vjetesh si te Zyra e Permbarimit A... dhe te Sherbimi Permbarimor S... sh.p.k palet debitore nuk kane kundërshtuar asnje veprim permbarimor duke mos pasur asnje kundërshti rreth paligjshmerise se kryer nga keto zyra permbarimore.

Nderkaq pala debitore, G. Q. ka depozituar kallzim penal ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Tirane ndaj permbaruesve te Shoqerise "Sherbimi Permbarimor S..." SHPK, per vepren penale te fallsifikimit te parashikuara nga neni 186 i K.Penal dhe Prokuroria ka regjistruar procedimin penal Nr. 5613 te vitit 2017 ne ngarkim te tyre. Nderkohe rezulton se edhe ndaj kallezuesit G. Q. nga pala kreditore eshte paraqitur nje kallezim penal per mashtrim me kredi pasi ka shitur automjetin Audi Q7 send i paluajteshem i lene si mjete garancie ndaj pales kreditore per permblusje te detyrimit kontraten e kredise Nr. 13045280 te dates 09.12.2011.

Me date 27.07.2017 jane paraqitur prane ambjenteve te shoqerise "Sherbimi Permbarimor S..." sh.p.k oficeret e policise gjyqesore, prane Prokurorise se Rrethit gjyqesor Tirane, Besjana Recai per te komunikuar dhe zbatuar Vendimin "Per sekuestrimin e dosjes permbarimore Nr. 0218-15 Regj" date 07.07.2017 te Prokurorit Ervin Karanxha prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane. Vendimi eshte percjelle nepermjet shkreses Nr.5613 Prot date 27.07.2017 te Drejtuesit te Prokurorise lidhur me procedimin penal Nr.5613/2017. Ne zbatim te vendimit te prokurorit te ceshtjes, oficeret e policise gjyqesore kane kryer sekuestrimin dhe perpilimin e Procsverbalit "Mbi sekuestrimin e sendeve" date 27.07.2017 ne baze te nenit 208 e vijues te K. Pro Penale duke marre fizikisht dosjet permbarimore te cilat permbarin vendimet gjyqesore ne origjinal sebashku me praktiken shkresore te permbaruesit gjyqesor te mbajtur respektivisht. Vendimi dhe veprimet e organit te akuzes jane haptazi ne kapercim te parashikimeve ligjore te cilat i sjellim te argumentuara ne vemendjen e gjykates;

Shkaku per te cilin kerkuesi i eshte drejtuar gjykates me ankimin object gjykimi, brenda afatit ligjor, per heqjen e mases se sekuestros duke kundersizuar Vendimin "Per sekuestrimin e dokumentave te dosjes permbarimore Nr. 0218-15" date 27.07.2017 te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane per te cilin eshte mbajtur Procesverbal "Mbi sekuestrimin e sendeve" date 27.07.2017 ne ambjentet e Shoqerise "Sherbimi Permbarimor S..." sh.p.k ne prani te permbaruesit gjyqesor, eshte parashtruar ne séance e shqyrtimit te kerkeses,ne prani te prokurorit dhe pasi u administruan aktet shkresore te nevojshme qe i perkasin ketij gjykimi.

**Ankuesi Shoqeria "Sherbimi Permbarimor S..." shpk ka parashtruar si me poshte vijon:**

Ne nenin 513/1 te K.Pr.Civile eshte parashikuar shprehimisht se:"Urdhri ekzekutimit leshohet vetem ne nje kopje". Sekuestrimi i vendimeve gjyqesore per leshimin e "Urdhrit te Ekzekutimit", te cilat jane kopje te vetme, ka pezulluar proceduren permbarimore te ekzekutimit duke cenuar direkt te drejtat e paleve ne proces ekzekutimi perkatesisht kreditorit M... C... A...sha.

Ne nenet 609,610 te K.Pr.Civile eshte percaktuar ne menyre taksative qe vetem gjykata kompetente mund te disponoje me vendim per pezullimin e veprimeve permbarimore.Nuk mundet organi i akuzes nepermjet veprimeve apo mosveprimeve te tij te pezulloje ekzekutimin e titujve ekzekutive.Pavaresisht se prokurori nuk eshte shprehur lidhur me afatin e shqyrtimit nga ana e tij te dokumentacionit ne dosjet permbarimore (perfshire vendimet gjyqesore urdhrat e ekzekutimit), procedura permbarimore mbetet e pezulluar per nje afat te pacaktuar. Ky fakt i shkakton nje dem mjaft te madh kreditorit ne kushtet e nje vendimi perfundimtar ne favor te kerkuesit, dem i cili me perfundimin e procesit penal behet i kerkueshem kunder shtetit ne rastin konkret. Pra me veprimet e tij organi akuzes ngarkon me detyrime shtetin.

Nuk jemi ne dijani te faktit se organi i akuzes te kete terhequr nga sekretaria e gjykates dosjet gjyqesore lidhur me praktiken e ndjekur per leshimin e secilit prej urdhrave te ekzekutimit per te konstatuar vlefshmerine juridike te tyre.

Do te ishte me e lehte, pa shkaktuar dem, pa pezulluar ekzekutimin qe prokurori te kerkonte nga gjykata qe ka dhene vendimin kopje te urdhrave te ekzekutimit.

Ne nenin 213 pika 1 te K.Pr.Penale eshte parashikuar se: "Organi procedues mund te urdheroje nxjerrjen e kopjeve te akteve dhe te dokumentave te ..".Ne rastin konkret kopje te njesuara te dokumentacionit do te ishin mese te mjaftueshme per prokurorin per te vazhduar hetimet.

**Nga** praktika rezulton se kallzimet penale ndaj veprimtarise/aktivitetit te permbaruesit gjyqesor sipas parashikimeve te nenit 186 te K.Penal per vepren penale te fallsifikimit jane te zakonshme dhe prokuroria gjate fazes hetimore gjithmone disponon kopje te praktikës permbarimore duke perfshire kopje te urdhrat te ekzekutimit (te njesuar nga zyra e permbarimit) sebashku me deklarimin e personave perkates te cilat sherbejne dhe ndihmojne per te vleresuar elementet e vepres penale, anes objektive dhe subjektive te saj.

Nuk ka shkak te ligjshem qe per nje veper penale ndaj permbaruesit gjyqesor te sekuestrohet nje vendim gjyqesor/urdher ekzekutimi duke cenuar te drejtat e pales kreditore dhe vonuar pa shkak ekzekutimin e vendimit. Kerkuesi apo mbajtesi i se drejtes qe certifikon urdhri i ekzekutimit eshte vetem kreditori M... C... A...sh.a dhe vetem vullneti i tij ose nje vendim gjyqesor mund te mbaje te pezulluar ekzekutimin e detyrimit ndaj pales debitore.

**Organi** i akuzes ka kryer sekuestrimin e sendeve ne zbatim te nenit 208/1 te K. Pr. Penale "ose prokurori disponojne me vendim te arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe te sendeve qe lidhen me vepren penale kur ate jane te domosdoshme per vertetimin e fakteve." Ne pjesen arsyetuese te vendimit te sekuestrimit jane dhene fakte dhe rrethana te pasakta lidhur me proceduren e ndjekur nga permbaruesi gjyqesor dhe mbi bazen e tyre eshte argumentuar sekuestrimi i vendimeve gjyqesore sebashku me dosjen permbarimore. Ky konstatim qe mund te kryhej ne cdo kohe nga prokurori i ceshtjes nuk justifikon sekuestrimin e vendimeve gjyqesore sebashku me dosjet permbarimore, duke ngritur paqartesi lidhur me vertetimin e cilave fakte eshte i nevojshem sekuestrimi i vendimeve/urdhrave te ekzekutimit te leshuar nga gjykata per te cilat rezultojne elemente te vepres penale te shperdorimit te detyres nga ana e permbaruesve gjyqesore.

Duke vleresuar se gjykata do te marre parasysh rrethanat e ceshtjes dhe argumentat lidhur me kapercimin e kompetencave te njohura nga ligji te organit te akuzes, si dhe cenimin e te drejtave te paleve ne proces ekzekutimi, do te mundesoje nje hetim te plote e te gjithanshem me vendimarrje te shpejte e te drejte sipas kerkeses se ankuesit.

**Perfaqsjesja e organit te akuzes,kerkoi rrezimin e kerkeses dhe lenien ne fuqi te** Vendimit “Per sekuestrimin e dokumentave te dosjes permbarimore Nr. 0218-15” date 27.07.2017 te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane per te cilin eshte mbajtur Procesverbal “Mbi sekuestrimin e sendeve” date 27.07.2017.

Ne arsyetimin e saj kjo gjykate ka parasysh dispozitat ligjore perkatese:

**Nenin 208 te K.Pr.Penale ku parashikohet se:**

1.Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.

2. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim.

3. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se është i pranishëm.

**Ne Nenin 212 te K.Pr.Penale i ndryshuar me nenin 115 te ligji nr.37/2017,dt.30.03.2017,ne te cilin eshte parashikuar se:**

**Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit**

1. I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë ne kërkimit të tyre, mund të bëjë ankim në gjykatë, e cila merr vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve.

2. Kundër vendimit të gjykatës lejohet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata e apelit jep vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve nga marrja e akteve.

3. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e vendimit.”.

**Arsyetimi ligjor i gjykatës.**

Referuar parashikimeve ne nenet e mesiper pershkruara ,gjykata cmon se Vendimi “Per sekuestrimin e dokumentave te dosjes permbarimore Nr. 0218-15” date 27.07.2017 te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane” per te cilin eshte mbajtur Procesverbal “Mbi sekuestrimin e sendeve” date 27.07.2017 ne ambientet e Shoqerise “Sherbimi Permbarimor S...” sh.p.k. i prokurorit te ceshtjes eshte mare ne perputhje me ligjin dhe per kete shkak duhet te lihet ne fuqi.

Konkretisht vendimi vjen conform parashikimit ne nenin 208/1 te K.Pr.Penale pasi jane sekuestruarprovat material te cilat kane lidhje me ceshtjen object hetimi te Prokurorise se Rr.Gjyqesor Tirane.

Patur parasysh natyren e hetimit dhe vepren penale te cilen po heton ky organ, mbi bazen e kallezimit te paraqitur nga ana e shtetasit G. Q., nr. 5613 per vepren penale te " Fallsifikimit te Dokumentave "te parashikuar nga neni 186 i K.Penal,veprimi hetimor I sekuestrimit te akteve qe perbejne objektin e hetimit,rezulton te jete nje veprim I nevojshem per vazhdimin e metejsheem te procedimit penal.Ne keto rrethana ne baze te nenit 208 te K.Pr.Penale,prokurori per nje hetim te plote e te gjithanshem te ceshtjes penale ka

vleresuar leshimin e vendimit te sekuestrimit ne original te dosjes permbarimore nr. 0218-15 Regj. te perrnbaruesit gjyqesor privat A. T. prane sherbimit permbarimore "S..." shpk, per venien ne ekzekutim e vendimit nr. 10910 regj.them date 20.11.2012 te Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tirane ne lidhje me titullin ekzekutiv",ku rezulton te jete e administruar edhe Kontrate Kredi Bankare " me nr : ... date 09.12.2011 me pale kredidhenes P... Bank sh.a, kreditore M... C... A...sh.a dhe debitor " B... 2007 " , deritore solidare E. Q., F. Sh., G. Q. .

Ne baze te nenit 208/2 te K.Pr.Penale me kete vendim,prokurori ka ngarkuar of.e policies gjyqesore,I cili ne zbatim te urdherit te sekuestrimit ka realizuar sekuestrimin e provave shkresore dhe ka mbajtur Proces verbalin perkates.

Ne konkluzion gjykata cmon se veprimet e prokurorit ne Vendimin "Per sekuestrimin e dokumentave te dosjes permbarimore Nr. 0218-15" date 27.07.2017 te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane,pasqyruar ne Proces verbalin "Mbi sekuestrimin e sendeve" date 27.07.2017 ne ambjentet e Shoqerise "Sherbimi Permbarimor S..." sh.p.k.jane conform ligjit,neneve 208 te K.Pr.Penale dhe per kete arsye duhet te mbeten ne fuqi.

Perfundimisht, gjykata cmon se ankimi I ankuesit Shoqerise "Sherbimi Permbarimor S..." sh.p.k. kunder Vendimit "Per sekuestrimin e dokumentave te dosjes permbarimore Nr. 0218-15" date 27.07.2017 te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane,nuk eshte I bazuar dhe duhet te rrezohet.

#### **PER KETO ARSYE**

Gjykata, bazuar ne nenin 212 te K.Pr.Penale

#### **V E N D O S I**

-Rrezimin e kerkeses.

-Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 5 diteve ne Gjykatën e Apelit Tirane.

**U shpall ne Tirane me dt.07.08.2017.**

**S E K R E T A R E**  
**BLERINA ORUÇI**

**G J Y Q T A R E**  
**FATIME DEÇOLLI**

#### **SHPENZIMET GJYQESORE**

Fletethirrje 2 me vlere me nga 100 leke/copa ne llogari te gjykates

**TOTALI 200 LEKE**

